

VENDIM
Nr.917, datë 29.7.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas shkronjës “b/1” të pikës 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave” të kreut V “Zhvillimi i procedurave”, të rregullave të prokurimit publik, që i bashkëlidhen vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet shkronja “b/2”, me këtë përmbajtje:

“b/2. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohet të kualifikojë për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, operatorët ekonomikë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t’u lidhur, sipas ligjit të prokurimit publik, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 për qind të vëllimeve të përgjithshme të punës. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve, ku secili prej tyre, për t’u kualifikuar për punë publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70 për qind të vëllimeve të përgjithshme të punës, që ai ka marrë përsipër të realizojë, në përputhje me kontratën e bashkëpunimit.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohet të kualifikojë për punë publike, të prokuroria sipas ligjit të prokurimit publik, ata kandidatë, të cilët, në çastin e hapjes së ofertave, brenda së njëjtës periudhë, janë kontraktorë/nëkontraktorë me këtë autoritet për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 për qind i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit të prokurimit publik nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha